



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 11.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.02.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Alfa I" për aktivitetin: "Mirembajtja dhe rindertimi i kanalizimit atmosferik në Komunen e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-7123-211** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Alfa I" e datës 10.02.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirembajtja dhe rindertimi i kanalizimit atmosferik në Komunen e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-7123-211**, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 05.02.2021, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 05.02.2021;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Alfa I" me datë 09.02.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirembajtja dhe rindertimi i kanalizimit atmosferik në Komunen e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-7132-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.02.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj është se Autoriteti Kontraktues ka kryer procesin e vlerësimit pa u bazuar në Rregullat për tenderet jonormalisht të ulet dhe si i tillë është i pa bazuar për faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit në disa Vendime të veta ka konstatuar se këto rregulla nuk duhet të aplikohen në rastet kur kemi kriter çmimin me të ulet me peshim si që ka qene edhe në këto aktivitet. Pra pretendimi juaj është në kundërshtim me këto konstatime.

Lidhur me termin e çmimeve manipulative në kemi vërejtur të njëjtat dhe si që mund të shihet edhe nga kërkesat për sqarime e edhe nga Njoftimet për refuzime të disa tendereve. Pra janë refuzuar tenderet e OE-ik që kanë dhënë çmime shumë të larta e që nuk mund të pranohen si çmime të tregut dhe nuk qëndron pretendimi juaj se kemi kërkuar sqarime vetëm për dy

pozicione sepse te tenderuesit qe kane pase çmime te tilla edhe ne pozicionet tjera jane kerkuar sqarimet.

Dua t'ua perseris se te aktivitetet me çmim me te ulet te peshuar zbatimin e Rregullores per tenderet jo normalisht te ulet e ka perjashtuar OSHP-ja, ndersa lidhur me çmimet me te larta nga çmimet reale te tregut kemi kerkuar sqarime dhe ne baze te analizes tone kemi refuzuar tenderet qe kane çmimet e tilla.

Dua t'ua perkujtoj se sqarimet per çmimet e larta jane bazuar ne piken 4.2 te Rregullave dhe Udhzuesit Operativ per Prokuirm Publik, ku eshte percaktuar si vijon:

4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim: a) të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasisë, karakteristikat teknike dhe garancive; b) për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet, dhe c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Lidhur me kete ka edhe nje interpretim te KRPP-se ne baze te kerkeses se nje Autoriteti Kontraktues lidhur me çmimet me te larta se çmimet e tregut te cilin ua paraqes ne vijim:

From: Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>

Sent: Thursday, December 24, 2020 9:25 AM

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Sa i përket **çështjes së ofrimit të çmimeve më të larta se çmimet reale të tregut**, KRPP sqaron se kjo çështje nuk është e rregulluar me ndonjë dispozitë të veçantë në ligj dhe legjislacionin dytësor, megjithatë KRPP konsideron se gjatë vlerësimit të tenderëve Autoritetet Kontraktuese, çdo herë duhet të mbajnë në mend qëllimin e Ligjit të Prokurimit Publik të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-së, i cili përcakton:

"Qëllimi i këtij ligji është të

sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë..."

Gjithashtu,

Autoritetet kontraktuese **duhet të sigurohen** që gjatë administrimit të procedurave të prokurimit të mos kontraktojnë me çmime më të larta se çmimet reale të tregut. Shih nenin 4.2 të Rregullave dhe Udhëzimit Operativ për Prokurim Publik, i cili përcakton:

"4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim:

- a) të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasisë, karakteristikat teknike dhe garancive;***
- b) për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet, dhe***
- c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut."***

Pra ne kete rast detyra jone primare ligjore ka qene qe te mos lejojme qe çmimi I kontraktuar te jete mbi çmimin e tregut,ndersa lidhur me çmimet jonormalisht te ulta detyrimisht kemi respektuar Vendimet e OSHP-se.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.


Verejtje: Bashkengjitur keni pjese nga nje Vendim i OSHP-se lidhur me perjashtimin e Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet te aktivitetet me çmimin me te ulet me peshim(poentim).

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 590/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi -Kryetar z. Blerim Dina-Referues z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "I.P.N.EU" SH.P.K & "BEREQETI-ING" SH.P.K – Prishtinë, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: "N.N.P Ndertimtari" - Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr.prok:616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën: 08.10.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "I.P.N.EU" SH.P.K & "BEREQETI-ING" SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr.prok: 616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

II. ANULOGHET, Vendimi i AK-së Njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr.prok: 616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë dhe lënda kthehet në rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

Kontraktues dëshminë që na kanë përcjell neve për procesverbal të hapjes dhe për këtë e kemi dëshmitë e-mail adresën që kemi kërkuar, me datën 19.06.2019 në ora 10:32 kemi dëshmitë edhe të e-prokurimit ku vazhdimisht informohemi kopja e uebfaqes për mos informim. Në sqarime kemi qenë dhe llogaritjeve që kemi bërë neve nuk na del i ulët, pozicioni i rrethojave është 40 euro dhe është pozicioni kryesor, dhe nuk kanë qenë të gjitha pozicionet jo-normalisht të ulëta.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: Sipas komisionit vlerësues gjatë sqarimit të tenderit OE ankues nuk kanë mundur të argumentojnë në sqarime dhe ka dhënë vetëm deklarata dhe sipas komisionit vlerësues kompania nuk ka mundur të arsyetoj çmimet.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Krasniqi deklaroj: Ofertat që kanë qenë shihet që të 3 kompanitë kanë qenë me të ulëta. AK nuk e ka përdorur rregulloren shihet që janë çmime shumë të ulëta. Unë mbes prapa raportit të dhen në ekspertizë. OE ankues ka ofertuar me çmim të poentuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Mushica deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhe poshtë ankesën e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Duke pas për bazë kriterin çmimi më i ulët i poentuar Autoritetit Kontraktues i lejohet që varësisht prej rëndësisë që kanë artikujt të mund të poentojnë në mënyrë që të vjen deri të çmimi më i arsyeshëm, pasi që vlerësimi i ofertave në këtë rast bëhet në bazë të poenave që i është dhënë secilit pozicion dhe për kontratë rekomandohet OE i cili ofron çmim më të ulët të poentuar, ndërsa kontrata nënshkruhet dhe realizohet sipas çmimeve të ofruara sepse tek ky kriter nuk lejohet që të përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm dhe se funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët.

Duke pas për bazë këtë Paneli shqyrtues vlerëson që kriteri i çmimit më të ulët me poentim , ka për qëllim shmangien e manipulimit me çmimeve përmes pozicioneve të ndryshme nga ofertuesit.

Poentimi çmimeve minimizon mundësitë e manipulimit me çmime pasi që çmimet poentohen në bazë të përqindjes së dhënë për secilin artikull apo për grup artikujsh.

Pra tek kriteri çmimi më i ulët me poentim Autoritetet Kontraktuese duhet eliminuar praktikat kur çmimet e njërit ofertues i krahason me çmimet e ofertuesve tjerë pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar me çmimet me ofertuesit tjerë, sepse në rastet kur kemi krahasimin e çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjënë zbatim Rregulla për Tenderët Abnormalisht të ulët, apo kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga piket maksimale përcaktohet fituesi, pra tek kriteri tenderi me çmimi më të ulët i poentuar për kontrate rekomandohet OE i cili ofron çmim më të ulët të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës,
- 1x1 OE- I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K- Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi